

**AKT THEMELIMI  
I  
SHOQËRISË**

**“VELA TRAVEL ” sh.p.k**

**Neni 1  
Krijimi**

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit” , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , “ Per shoqerite tregatre” dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin e tij te lire , te shprehur dhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi nga ortaku themelues :

PETRIT SHALIANI lindur ne Ndermenas me 13.02.1972, IDENTIFIKUAR ME numer KARTE IDENTITETI 036429936 DHE NUMER PERSONAL H20213016U, krijon Shoqerine me Pergjegjesi te **“VELA TRAVEL ” sh.p.k** me akt themelimi si vijon :

**Neni 2  
Personaliteti juridik**

Shoqeria Fiton personalitet juridik pasi te jete regjistruar prane QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara ne ligj.  
Shoqeria **“VELA TRAVEL ” sh.p.k** eshte nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar.

**Neni 3  
Selia**

Shoqeria **“VELA TRAVEL ” sh.p.k** do te kete seline ne Fier, Dermenas, pasuria nr.36/87, zona kadastrale 1471.  
Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me vendim te Asamblese se Ortakeve.


**Neni 4  
Objekti i veprimtarise**

**Transport rrugor nderkombetar udhetaresh me autobus, Transport udhetaresh me autobus brenda vendit. Transport rrugor kombetar dhe nderkombetar mallrash per te trete dhe me qira.**

Shoqeria mund te ndryshoje shtoje ose pakesoje objektin e verpimtarise se saj me vendim te Asamblese se Ortakeve.

**Neni 5  
Kohezgjatja e shoqerise**

Kohezgjatja e shoqerise fillon me regjistrimin e saj juridik dhe fiskal ne QKB regjistrin tregtar dhe do te vazhdoje deri me 31.12.2091 dhe mund te vazhdoje.



## **Neni 6** **Kapitali Themeltar**

Kapitali fillestar I shoqerise private **“VELA TRAVEL ” sh.p.k** do te jete 1.000 (njemije leke ).

Kapitali i shoqerise ndahet ne nje numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga cdo ortak ne shoqeri ku cdo ortak zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri, kuota keto te shlyera nga ortaket dhe te ndara si me poshte:

**PETRIT SHALIANI** zoteron 1 (nje) kuote me vleren 1.000 (njemije leke ) ose 100 % te kapitalit themeltar.

Kontributi e ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta). Ortaku pergjigjet per humbjen e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltarte shoqerise.

## **Neni 7** **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtave qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

1. Kontributi ne kapitalin e shoqerise
2. Shitblerjes
3. Trashegimise
4. Dhurimit
5. Ne cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata behet me shkrim, personi kalon kuoten dhe ai qe fiton ate, pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga casti i kalimit te kuotave, deri ne castin e rregjistrimit te saj ne QKB, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 3.05.2007 per QKB. Rregjistrimi i kalimit tekuotave ka efekt deklarativ. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

## **Kreu II** **Organet vendimarrrese dhe drejtuese** **Neni 8** **Organi Vendimarrres**

Asambleja e pergjithshme eshte organi i vetem vendimarrres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Te drejtat dhe detyrimet e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortaket ne respekt me kuotat e tyre ne shoqeri. Cdo ndryshim ne statut dhuhet depozituar prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise

Ndryshimin e statusit

Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve

Percaktimin e shperblimeve per administratorin, likuiduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar

Mbikqyrjen e zbatimit te politikave nga administratori, perfshire pergatitjen e pasqyrave financjare dhe raporteve te ecurise se veprimtarise.

Miratimin e pasqyrave financjare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise



Zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit  
Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre  
Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe procedime te tjera ndaj  
Administratorit  
Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise  
Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjes se asamblese  
Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti  
Shperndarjen e fitimive vjetore dhe mbulimin e humbjeve  
Investimet  
Te bleje te shese kembeje pasurite patundshme te shoqerise.  
Vendimet e paregjistruara me regjistrimin e vendimeve jane absolutisht te  
pavlefshme. Vendimet e marra rregjistrohen ne nje rregjister te vendimeve te  
dhenat e te cilat nuk mund te ndryshohen apo fshihen.

### **Neni 9 Administrimi**

Shoqeria private **"VELA TRAVEL " sh.p.k** ka administrator **Z. PETRIT SHALIANI**.

Administratori emerohet ne kete detyre per nje afat 5 vjecar me te drejte  
riperteritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese së  
Përgjithshme.

### **Neni 10 Kompetencat**

Administratori ka te drejte e detyrohen te:

Kryerje te te gjitha veprimeve dhe administrimit te veprimtarise tregtare te  
shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga assembleja e  
pergjithsme.

Perfaqesoje shoqerine tregtare

Kujdeset per mbajtjen e sakte te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel  
te shoqerise

Te nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dh raportin e ecurise se  
bashku me propozimet per shperndarjen e fitimve duke i paraqitur keto  
dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim.

Krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe  
kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.

Te kryeje rregjistrimet dhe te dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise sic  
parashikohet ne ligjin per QKB.

Te hape llogari bankare dhe te operoje per llogari te kompanise pa limit.

Te kerkoje financime pa limit per kompanine nga banka dhe instituzione te tjera  
financjare.

Administratori eshte i detyruar te therrase mbledhjen e Asamblese se  
Pergjithshme ne rastet kur:

Sipas Bilancit Vjetor apo raporteve financjare, rezulton ose ekziston rreziku qe  
aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve  
ne vazhdim dhe kur shoqeria , brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj,  
propozon blerje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% e asetave  
te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Admiistratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te

zakonshme e te jashtezakonshme. Ai perfaqeson shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu dhe autoritet gjygesore te te gjitha shkalleve. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te trete ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji i jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

#### **Neni 11** **Viti financiar**

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor. Me perjashtim te vitit te pare financiar qe fillon nga data e rregjistrimit te shoqerise ne QKB.

#### **Neni 12** **Shperndarja ose prishja eshoqerise te behet ne cdo kohe:**

Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar me themelimin e saj  
Me vendimin e ortakeve  
Me hapjen e procedurave te falimentimit  
Nese nuk ka veprimtari per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit 9723 date 03.05.2007 per Qendren Kombetare te Rregjistrimit.  
Me vendimin e gjykates  
Per kete rast assembleja e pergjithshme merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen " Shoqeri ne likuidim e siper".

#### **Neni 13** **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe me dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut , do te zbatohen dispozitat e ligjit per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, Kodi civil dhe cfaredo ligji tjeter specific ne Republiken e Shqiperise.

#### **Neni 14** **Dispozita Perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua ne 2 kopje ne gjuhen shqipe me permbajtje dhe vlera te njejta juridike. Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim nen per nen nga ortaku themelues i shoqerise tregtare "**VELA TRAVEL** " **sh.p.k** nenshkruhet nga ortaku themelues dhe ne te gjitha faqet.

**FIER, 09-01-2023**

Per "**VELA TRAVEL**" **sh.p.k**

**ORTAKU THEMELUES**  
**PETRIT SHALIANI**

*Petr Shaliani*  
*[Signature]*